

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: 02-1481
Data / Datum / Date: 13 / 08 / 20 21
Shtojca / Dodaci / Annex: -2-
PRISHTINË/A



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Prade - Ministry of Justice

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. 66 / 2021

Datë: 13 / 08 / 2021

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (GZ/Nr. 7/01 mars 2019, Prishtinë), duke u bazuar në nenin 37 dhe nenin 39 të Ligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr:

V E N D I M

1. Znj. Lyra Çela, caktohet zyrtare për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Zyrtarja për mbrojtjen e të dhënave personale pika 1 e këtij vendimi ka këto detyra:

2.1.informon dhe këshillon kontrolluesin ose përpunuesin dhe të punësuarit, të cilët kryejnë përpunimin mbi detyrimet e tyre në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore për mbrojtjen e të dhënave;

2.2. jep këshilla, sipas rastit, në lidhje me vlerësimin e ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave dhe monitoron performancën në pajtim me nenin 35 të Ligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, (më tej: Ligji);

2.3. bashkëpunon me Agjencinë për Informim dhe Privatësi;

Faqe 1 nga 2

2.4. vepron si pikë kontakti për Agjencinë për çështjet në lidhje me përpunimin, duke përfshirë konsultimin paraprak, të referuar në nenin 36 të ligjit dhe konsultohet, sipas rastit, në lidhje me çdo çështje tjetër.

3. Obligohet zyrtarja nga pika një (1) e këtij vendimi që mbrojtjen e të dhënave personale ta trajtojë në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Caktimi i zyrtarit/es për mbrojtjen e të dhënave personale është obligim ligjor i çdo institucioni, përkatësisht punëdhënësi, ku si të tillë e përcakton neni 37 i Ligjit, andaj, me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor, vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ardian Bajraktari

Zv. Sekretar i Përgjithshëm



Vendimi i'u dërgohet:

- Zyrtares për mbrojtjen e të dhënave personale/znj. Lyra Çela;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm/MD;
- Arkivit të MD-së.

Faqe 2 nga 2